



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	22.09.2023	30.09.2023	2023/0714

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 20.09.2023, OE “ **MOVIOLA " L.L.C."**- **Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0714**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “**Tatamata Bashkim Femi 39**”- **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Angazhimi i nje OE per PR-Public Relation per MMPHi**” me nr. të prokurimit: “**210-23-7815-2-2-1**”, iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapesinor**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **90,000.00 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Shkelja e dispozitës referuar LPP dhe Rregullores nr. 001/2023 per prokurim publik,

Neni 4. Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit, pika.c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut, dhe nenit, 4.3 Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të vepohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial.

Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial. a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efektive dhe me efektive.

Sqarim:

Ne si OE kemi dorëzuar ofertën pranë Autoritetit Kontraktues duke plotësuar kriterin bazë të procedurës, oferta e përgjegjshme me çmimin me te lirë, duke ofruar ofertën në vlerë prej: 67, 968.00 €, ndërsa çmimi i ofertës të OE, të shpallur fitues është: 85, 940.00 €, me një ndryshim më të lartë se sa oferta jonë në vlerë prej: 17, 972.00 € .

AK, siç mund të shihet në arsyet e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim ka dhënë arsye ku me vetëdije të plotë deklaron se çmimi i ofertës fituese është brenda vlerës së parashikuar të kontratës, duke mos marrë për bazë se oferta jonë është më e lirë prej 17, 972.00 € se oferta fituese, duke shkelur kriterin kryesor të procedurës, kriterin: “ oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë ” të njëjtën kohë ofertën tonë e kanë vlerësuar si të papërgjegjshme, pa asnjë argument, vetëm duke krijuar arsye fiktive, ku për këtë do të ju oforjmë dëshmi të mjaftueshme të cilat argumentojnë shkeljet e AK, të LPP dhe Rregullores për Porokurim Publik, në nenet përkatëse.

Lidhur me kërkesën për certifikatën e biznesit, kërkesa si në vazhdim:

1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit .

1. Çertifikata e regjistrimit tw biznesit - kopje .

Dëshmi:

Me ankesë do të bashkangjesim deklaratën nën betim të dorëzuar me ofertë.

Sqarim 2:

Po ashtu lidhur me plotësimin e deklaratës nën betim e gjeni të bashkangjitur edhe interpretimin nga KRPP A duhet kërkuar sqarime shtesë në bazë të nenit 72 të LPP-ës, në rast se Operatorët Ekonomik nuk e dorëzojnë bashkë me ofertat e tyre "Deklaratën nën betim" ?

"Deklarata nën betim" është kusht administrativ dhe dëshmi që kërkohet sipas nenit 65 të LPP-së për të dëshmuar përshtatshmërinë e OE-së për pjesëmarrje në aktivitetin aktual të prokurimit (pra që është në fazën e tenderimit) dhe si e tillë ajo nuk mund të kërkohet në bazë të nenit 72 të LPP-ës, ngase ekzistenca e saj (pra e deklaratës nën betim) nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive nga AK siç e kërkon paragrafi 3 i nenit 72 të LPP-ës. Pra me një fjalë, deklarata nën betim nuk është një dokument i cili e plotëson kërkesën e paragrafit 3 të nenit 72 të LPP-ës, për këtë arsye, Deklarata nën betim, duhet të nënshkruhet vulozet.

AK, për të njëjten kërkesë ka kërkuar sqarim shtesë dhe pas kërkesës për sqarim ne i kemi ofruar dokumentet me ndryshimet e fundit (dokumente këto të leshuara nga ARBK në bazë të kërkesës së bërë nga AK) e cila vërteton se statusi është i regjistruar.

Ne e kemi dorëzuar sqarimin sipas kërkesës të AK, me datë: **24.08.2023**. Përkundër ofrimit të sqarimeve, AK nuk i ka marrë për bazë dhe si arsytim të eliminimit ka ofruar një 'screenshot' nga web-faqja e ARBK-së ku biznesi jonë figuronte si "pasiv" gjë e cila është e pakuptueshme sepse ne kemi marr dokumenta nga ARBK të leshuara me datë **24.08.2023** dhe në asnjë moment nuk na është tërhequr vëmendja se biznesi jonë figuron si "pasiv".

Vlen të ceket se në kërkesën për sqarim nuk është përmendur asnjëherë çështja e statusit dhe si të tillë ne nuk kemi pasur pasqyrë të plotë të kësaj kërkesë specifike. Për më tepër, edhe gjatë procesit të tenderimit dhe ofertimit, ne kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme rrethanore se kemi qenë biznes aktiv përmes qarkullimit bankar në 3 vitet e fundit (sipas kërkesës në tender), jemi tatim pagues të rregullt, deklarues të TVSH si dhe vërtetim nga Gjykata relevante se nuk kemi qenë në proces falimentimi. Të gjitha këto dëshmojnë që kompania jonë ka operuar në mënyrë aktive nga themelimi i saj.

Pas njoftimit për vendim të eliminimit të kompanisë tonë nga AK me arsyetimin e lartëcekur, ne kemi hyrë në web-faqen e ARBK dhe nuk na ka dal pretendimi i AK se biznesi jonë është 'pasiv' por ka dal " i regjistruar". Kështuqë, përshkakë se për neve është e tejet e paqartë se si ka mundësi të figuroj biznesi "pasiv" për AK, kemi kërkuar vërtetim dhe konfirmim nga Institucioni Zyrtar ARBK i cili e ka lëshuar dokumentin (certifikatën e biznesit) dhe i njëjti ka vërtetuar se statusi i certifikatës tonë të biznesit është status " i regjistruar " dhe jo status " pasiv " siç e ka arsyetuar AK në eliminimin e ofertës tonë.

Dëshmi:

Konfirmimin (dëshminë) për këtë, nga ARBK e gjeni të bashkangjitur me Ankesë. Shkelja e dispozitës, Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve.

45.17 Si një masë paraprake, autoriteti kontraktues duhet të kontrollojë se tenderët janë në përputhje me kërkesat formale të dosjes së tenderit, me fjalë të tjera përgjegjshmëria në një kuptim formal. Një tender konsiderohet të jetë formalisht i përgjegjshëm, në qoftë se përmbush të gjitha kërkesat formale në dosjen e tenderit, pa devijuar substancialisht nga apo pa i bashkangjitur atyre kufizime.

Sqarim:1

AK, e ka vlerësuar si të papërgjegjshme dëshminë për kërkesën: Deklarata nën Betim, duke ofruar sqarim se deklaratën nën betim nuk e kemi plotësuar sipas aneksit 2 të dosjes së tenderit.

Lidhur me kërkesën/dëshminë, Deklarta nën Betim konsiderojm se i përmbanë të gjitha kushtet për të qenë e përgjegjshme, referuar dëshmime dhe argumenteve si në vazhdim.

Referuar dosjes së tenderit dhe pjesës udhëzuese për plotësimin e kërkesës, Deklarata nën Betim.

Dosja e tenderit, Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik neni 6.4, **Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.**

Siq mund të shihet ne si Operator ekonomik konkurues të përgjegjshëm me çmimin më të ulët e kemi ofruar/plotësuar deklaratën nën betim sipas nenit 6.4. të përcaktuar dhe kërkesës së dosjes së tenderit sipas aneksit 2.

VENDIM ·

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik të anuloj njoftimin mbi Vendimin e AK. ·

Ti merrë për bazë dëshmitë dhe argumentet e paraqitura.

Lëndën të kthejë në favor tonin dhe AK oferten tone ta trajtoj si të përgjegjshme.

KRITERET PËR VLERËSIM

Njoftimi për kontratë:

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit 2.Regjistrimi i TVSH; 3.Certifikata e numrit fiskal – kopje	Certifikata e regjistrimit te biznesit – kopje Certifikata e TVSH – kopje Certifikata e numrit fiskal – kopje Nëse ne Certifikatën e Regjistrimit te biznesit është i shënuar edhe numri fiskal atëherë Certifikata e Regjistrimit te Biznesit shërben edhe si dëshmi e Certifikatës

III.2) KUSHTET PËR PJESEMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
Per lot 1 dhe 2 Kërkesat a. OE duhet te përmbush kërkesat e specifikuara ne nenin 65 te Ligjit te Prokurimit Publik (LPP) , Ligji nr. 04 L-42.LPP mund shkarkohet nga http; krpp.rks.net a.1. Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë te Ligjin Nr. 04 L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 05 L -092, Neni 65 , siç është e cekur ne Pjesën , te Aneksit 2	Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04 L-042, Neni 65 <u>duke përdorur formën në Aneksin 2. (origjinali)</u>

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "MOVIOLA " L.L.C.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Angazhimi i nje OE per PR-Public Relation për MMPHi" me numër të prokurimit: "210-23-7815-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Angazhimi i nje OE per PR-Public Relation për MMPHi

Nr. i prokurimit ²	210-23-7815-2-1
Nr i brendshëm	MMPHI 205 23 027 221

Radhë 1	Lënda : Angazhimi i nje OE per PR-Public Relation për MMPHi	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1	Grup i Operatorëve Ekonomik MOVIOLA L.L.C.; PLATFORM ADVERTISING L.L.C. Rruga Isa Kastrati, Prishtine	67,968.00 EUR
2	Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.SH. THUMBS UP ; Maximus Team L.L.C. Tringe Smajli H29/2, Prishtine	69,157.44 EUR
3	AMC CORPORATION SH.P.K. Lagja Dardania 1/5, 1/6, 1/7, Zona I, Prishtinë 811486184	76,180.80 EUR
4	Tatamata Bashkim Fehmiu 39, Prishtine 600275053	85,940.00 EUR

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës shpërblen me kontratë Tatamata Bashkim Fehmiu 39, Prishtine 600275053 me çmimin e ofertës për: ne vlere prej 85,940.00 euro.

Data: 04.09.2023

Emri dhe mbiemri i ZPP: Ndriçim Mustafa

PROCESVERBALI PËR EKZAMINIMIN , VLERËSIMIN DHE KRAHASIMIN E TENDERËVE

Në procesverbal, komisioni vlerësues duhet të jep informacione në detaje lidhur me përmbajtjen e secilit tender duke u bazuar në kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë administrative:

1.	Grup i Operatorëve Ekonomik MOVIOLA L.L.C.; PLATFORM ADVERTISING L.L.C.	Tek deklaratat nen betim të dy anëtarët e konezerciumit nuk e kane dorëzuar ne baze të kërkesës të kërkesa e përshtatshmërisë pasi qe kane ndërhyre ne formën e aneksit 1 te origjinalit.
----	--	---

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" MOVIOLA " L.L.C.**

Aktiviteti i prokurimit: **"Angazhimi i nje OE per PR-Public Relation per MMPHi"** me nr. të prokurimit: **"210-23-7815-2-2-1"**, iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**, ka publikuar njoftimin për kontratë me datë 27.07.2023, hapja e ofertave është bërë me datë 18.08.2023 si dhe vendimi mbi anulimin është publikuar me datë 05.09.2023.

OE ankuesi pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, me datë 08.09.2023 ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së duke pretenduar se AK ka eliminuar pa të drejtë.

OE ankuesi është eliminuar me arsyetimin:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “” **MOVIOLA " L.L.C.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Angazhimi i nje OE per PR-Public Relation për MMPHi**” me numër të prokurimit: “**210-23-7815-2-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**

Komisioni i vlerësimit konstaton se edhe pas kërkesës për sqarime shtese sa i përketë certifikatës se biznesit për anëtarë e konezerciumit **MOVIOLA L.L.C.** ju nuk e keni ofruar certifikatën me ndryshime ne ARBK , andaj ne baze te verifikimit ne ARBK del te jete se biznesin e keni pasiv:

MOVIOLA L.L.C.

Emri i biznesit	MOVIOLA L.L.C.
Emri i regjistrimit	00
Lloji i biznesit	Shërbime të përgjithshme të kufizuara
Numri i identifikimit	010178009
Numri i biznesit	00
Numri i kapitalit	00
Numri i identifikimit KTB	00
Numri i identifikimit	1
Data e regjistrimit	27/11/2018
Komuna	Prishtinë
Adresa	Prishtinë, Rruga 84 Keshari
Telefoni	063312895
E-mail	info@moviola.com
Kapitali	1.000.000
Statusi ne ARBK	Pasiv 05/04/2022
Statusi ne KTB	00

Perfaqësues i autorizuar

Ndërsa sa i përket edhe dekoratave nën betim ju njoftoj se te dy anëtarët e konezerciumit nuk e kanë plotësuar deklaratat nën betim siç ka qene deklarata ne ANEKSIN 2 mirëpo kanë bere ndërhyrjen ne formularin e dorëzimit te deklaratës pasi qe kanë fshi emrin e projektit dhe nr., e prokurimit për këtë projekt. Shih shembullin si kanë dorëzuar deklaratat dhe si është dashtë me qene tek aneksi 1 i FDT-se:





Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: **Moviola LLC** deklaroj nën betim se jam i përshatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose moshtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	Moviola LLC
Adresa e plotë:	Rruga Isa Kastrati, Prishtinë 10000, Kosovë
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Vesa Broqi
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	16 August 2023
Vula:	

Pretendimet e OE ankuesit janë kundër eliminimit të tyre nga AK:

Tutje, Eksperti Shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, OE ankuesi në ofertë ka të bashkangjitur deklaratën nën betim të cilën deklarata ka ndërhyrje pasi e ka shkarkuar nga e-prokurimi, deklarata nën betim nuk posedon tutillin e aktivitetit të prokurimit, numrin e prokurimit, por ka të vendosur logon e biznesit, përkundër që AK ka specifikuar edhe në njoftimin për kontratë lidhur me kërkesën. Mirëpo meqenëse deklarata është e bashkangjitur, si dhe marrë parasysh qëllimin e aktivitetit të prokurimit sipas nenit 1, 6, 7 të LPP-së, ku i njëjti është më i lirë se sa OE i rekomanduar për rreth 17 mijë e 900 euro, atëherë mendoj se AK këtë devijim mund ta konsideron si devijim i vogël konform nenit 59.4

të LPP-së. Andaj si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet pjesërishtë i bazuar.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04 L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2. (origjinali)

Numri i Prokurimit: 210-23-7815-2-2-1 – Titulli Angazhimi i nje OE per PR-Public Relation pë MMPHi

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kurse, sa i përket arsyes tjetër të eliminimit, lidhur me vlefshmërinë e biznesit, ne verifikuam në ARBK ku shihet se biznesi ka statusin regjistruar, po ashtu vërtetimi i ATK-së është valid, mirëpo AK gjatë procesit të rivlerësimit mund që të kërkoj nga agjensioni një vërtetim nëse ka dyshuar në OE ankuesin, pas përgjigjes në sqarim, dhe si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Mungon Certifikata e regjistrimit të biznesit	Mund të kërkohe informata sqaruese	66
Mungon Certifikata e TVSH	Mund të kërkohe informata sqaruese	66
Mungon Certifikata e numrit fiskal	Mund të kërkohe informata sqaruese	66

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërishtë e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " " MOVIOLA " L.L.C.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Angazhimi i nje OE per PR-Public Relation për MMPHi" me numër të prokurimit: "210-23-7815-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – " MOVIOLA " L.L.C.

Blerina Huruglica

